REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr.2504 Prot Vlorë, më 29.09.2026

VENDIM

Nr. 16, datë 25.09.2026

PROPOZIM PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR PËR Z. KRESHNIK TOMOR ÇIPI

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 25.09.2026 në mbështetje të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar si dhe kërkesës së Z. Kreshnik Tomor Çipi për përfitim shtese pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 2308 Prot, datë 14.09.2026,

VENDOSI;

1. T'i propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e shtesës së Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zotit Kreshnik Tomor Çipi, për talentin dhe personalitetin e tij të gjithanshëm të treguar në lojën e futbollit, duke dëshmuar cilësi të rralla si protagonist e kapiten i skuadrës së "Flamurtarit" dhe titullar i ekipit kombëtar.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social/Sektori i Ligjshmërisë, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit në Këshillin e Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë!

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Jurist

Alma Myrtaj

KRYETARI

Ervis Moçka
(nënshkruar dhe vulosur)

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, kanë të drejtë për pensione të posaçme që jepen nga shteti personat që:

a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur Z. Kreshnik Tomor Çipi, i lindur më [redacted] Vlorë, dhe banues në Vlorë, ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfitim shtesë Pensioni të Posaçëm Shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 2308 Prot, datë 14.09.2026, kërkesë e cila mbështetet në punën e palodhur shumëvjeçare, profesionalizmin, integritetin dhe përkushtimin në zhvillimin e sportit të futbollit dhe në afirmimin e vlerave më të mira sportive.

Qyteti i tij i lindjes, Vlora nuk i dha vetëm bregdetin dhe dritën e tij, por edhe pasionin e parë për topin dhe fushën e gjelbër. Si shumë fëmijë të brezit të tij, hapat e parë në sport i hodhi nëpër lagjet e Vlorës, aty ku loja bëhej ëndërr dhe ëndrra bëhej dëshirë për t'u dalluar. Ajo dëshirë nuk mbeti thjesht fëminore por u kthye në një nga karrierat më të spikatura të futbollit shqiptar.

Për 19 vjet, nga viti 1973 deri në 1992, Kreshnik Çipi veshi fanellën e Flamurtarit, klubi që u bë identiteti i tij sportiv dhe njëkohësisht, pasqyrë e krenarisë vlonjate. Në këtë periudhë, ai u bë kampion kombëtar në sezonin 1990 – 1991, nënkampion katër herë (1982, 1986, 1987, 1988), fitues dy herë i Kupës së Republikës (1985, 1987) dhe fitues dy herë i Superkupës (1988, 1991). Për një dekadë të tërë mbajti stemën e kapitenit të

Flamurtarit, duke udhëhequr ekipin me përgjegjësi, autoritet dhe shembullin personal në fushë.

Talenti i tij nuk mbeti brenda kufijve të klubit. Që në vitin 1980, në moshën vetëm 22-vjeçare, më i riu në atë kohë, u thirr në ekipin kombëtar të Shqipërisë, ku vazhdoi deri në vitin 1992, duke luajtur takimin e tij të fundit në fanellën kuqezi në Spanjë. Po në vitin 1980, pati privilegjin dhe përgjegjësinë të veshë fanellën e Dinamos në Kupën e Kampionëve të Europës, duke përfaqësuar futbollin shqiptar në skenën europiane.

Pas përfundimit të karrierës si futbollist, kontributi i Kreshnik Çipit për sportin nuk u ndal, por mori formë tjetër, atë të organizimit dhe të ndërtimit institucional. U zgjodh për dy mandate në Kryesinë e Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), ku në mandatin e parë, me votim, mori detyrën e Zëvendës-Presidentit. Në këtë cilësi, u bë autor i "Statusit të Futbollistit" dhe i "Statusit të Trajnerit", dy dokumente që kanë shërbyer si shtyllë rregullatore në fushën e futbollit në Shqipëri.

Formimi i tij shkollor shkoi paralelisht me përkushtimin sportiv, u diplomua në Akademinë e Sporteve më 15 maj 1990 dhe mori diplomën Bachelor në Drejtësi, dëshmi e një jete që nuk u mjaftua vetëm me lavdinë e fushës, por kërkoi edhe thellim intelektual e qytetar.

Bashkëlidhur kërkesës/propozimit gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Çertifikatë personale, me datë 10.09.2026;
- Çertifikatë familjare, me datë 10.09.2026;
- Fotokopje letërnjoftimi elektronik;
-Vërtetim për lloj dhe masë pensioni nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore/Drejtoria Rajonale Vlorë Nr. 1846 Prot datë 10.09.2026;
- Kopje e noterizuar e Titullit "Mjeshtër Sporti i RPSSH në sportin e Futbollit" me motivacion "Ka rritur mjeshtrinë sportive duke plotësuar kërkesat e klasifikimit unik. Ka qëndrim të mirë moral e politik dhe gëzon simpatinë e masave sport - dashëse", dhënë nga Komiteti i Këshillit të Përgjithshëm të Bashkimit të Fizkulturistëve dhe Sportistëve të Shqipërisë, datë 28.12.1990;
- Kopje e noterizuar e Titullit "Mjeshtër i Madh" dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 10963, datë 23.11.2018 me motivacion "Për talentin dhe personalitetin e tij të gjithanshëm të treguar në lojën e futbollit, duke dëshmuar cilësi të rralla si protagonist e kapiten i skuadrës së "Flamurtarit" dhe titullar i ekipit kombëtar";
- Kopje e noterizuar e Titullit "Kalorës i Urdhërit të Flamurit", Ekipit "Flamurtari" dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 10961, datë 23.11.2018 me motivacion "Për rezultatet historike në futbollin shqiptar, veçanërisht në përballjet për

kupat e Europës (1986-1987), duke manifestuar vlerat më të mira të sportit tonë, në arenën ndërkombëtare";

- Kopje e noterizuar e titullit "Qytetar Nderi i Vlorës", dhënë ekipit "Flamurtari të viteve 1980–1990" nga Këshilli i Bashkisë Vlorë, me Vendim Nr. 103, datë 29.12.2023, me motivacion "Për rezultate të shkëlqyera në arenën ndërkombëtare, si dhe kontributin dhe përfaqësimin me dinjitet të futbollit Vlonjat e Shqiptar";
- Kopje e noterizuar e titullit "Medalje e artë për merita në fushën e sportit" dhënë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me motivacion "Për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe përhapjen e sportit të futbollit si dhe rezultatet e arritura në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare".

Duke u bazuar në kërkesën e z. Kreshnik Çipi, në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, mendojmë se personi i propozuar plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.

Specialist/Jurist

Alma Myrtaj